



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes :	71041-00696-11-2017	Data e Regjistrimit :	09/05/2017
Numri i Vendimit:	11-2017-4471	Data e Vendimit :	19/09/2017

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Eda Kaja

SEKRETARE: Mimoza Cani

Sot më datë 19/09/2017mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {...}, i biri i {...} dhe i {...}, i datëlindjes {...}Kërkues {...}, i biri i {...} dhe i x, i datëlindjes {...}

Objekti:Heqja e masës së sekuestros së vendosur me vendimin e Prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës date 26.11.2015 kundër kërkuesëve {...} dhe {...}i mbi depozitat e tyre bankare.

Baza Ligjore:Neni 208 e vijues, neni 212 e vijues i K.Pr.Penale.

Në seancën gjyqësore të datës 19.09.2017, të zhvilluar në prani të kërkuesit dhe, mbrojtësit së zgjedhur prej tij Av.Idajet Beqiri, si dhe Prokurore Rabiana Halili, gjykata pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra deri tani në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit si dhe dëgjoi kërkesat e palëve, të cilat kërkuan:

Kërkuesi: Heqjen e masës së sekuestros së vendosur me vendimin e Prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës date 26.11.2015.

Prokuroria: Rrëzimin e kërkesës.

VEREN :

Vëren:

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Durrës ka regjistruar procedimin penal dhe po kryhen hetime për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale" që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal dhe nga hetimet e kryera del se:

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është regjistruar procedimi penal nr 2185/2015 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të vepres penale e veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal mbi bazën e materialit paraprak të percjelle nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës sipas informacionit të percjelle nga Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave Tirane, pasi shtetasi {...} kishte kryer transaksione bankare dhe kishte akumuluar shumën prej {...} në llogaritë e tij bankare, shumë e cila ishte e pajustificuar me burimin e të ardhurave të deklaruara nga ky shtetas dhe familjarët e tij.

Në kuadër të këtij hetimi është vendosur sekuestrimi në bankat e nivelit të dytë të shumave të depozituara në llogaritë rrjedhese për shtetasit:

Me shkresën nr 34894/1 datë 27.11.2015 Raiffeisen bank është kryer bllokimi i llogarisë në emër të {...} në vlerat {...} , {...}, {...}, {...}, {...}, {...} {...}, {...} si dhe në emër të {...} i në vlerat {...} {...}, {...}, {...}.

Me shkresën nr 1106 datë 26.11.2015 Procredit Bank është bllokuar llogaria në emër të shtetasit {...} i në vlerat {...} leke, {...}, {...} dhe {...}

Nga hetimet ka rezultuar se shtetasi {...}, në vitin 1996 është martuar me shtetasen angleze {...} {...} e datelindjes {...}. Në 30 Prill të vitit 2001, bashkejetuesja e tij ka vdekur. Duke qenë se ajo nuk kishte fëmijë dhe të afërm të saj, trashgimtare, e gjithë pasuria që ajo kishte, sipas legjislacionit vendas i kalon atij. Martesën e ka kryer në Londer, në zyrën e regjistrimit të martesave dhe ka jetuar me të, në adresën " {...}

". Pas vdekjes së saj, ka shitur shtëpinë ku kanë jetuar bashkë, me një vlerë prej {...} GBP por nga kjo shumë ka përfituar vetëm {...} GBP. Gjithashtu lidhur me burimin e të ardhurave të krijuara shtetasi {...} ka deklaruar se gjatë gjithë kësaj kohe ka qenë emigrant ekonomik në shtetin e Anglisë dhe se ka punuar pa qenë i regjistruar pa dokumenta, ka punuar si mjek popullor et.j

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në vazhdim të hetimeve, ka percjelle autoriteteve britanike dy leterporosi me anë të të cilave kerkohen marrja e provave dhe verifikimi i pretendimeve të paraqitura nga shtetasi {...} lidhur me benefitet e përfituara nga martesën me shtetasen britanike {...} dhe mënyrën se si i ka krijuar keto të ardhura si dhe marrjen e provave të tjera në funksion të hetimit të zhvilluar. Është vendosur pezullimi i hetimeve të procedimit penal nr 2185/2015 në pritje të leterporosive së autoriteteve britanike dhe me Vendimin e datës 26.11.2015, është vendosur sekuestrimi në Bankat e Nivelit të Dytë të shumave të depozituara në llogaritë rrjedhese, nga shtetasi {...}.

Vendimi i mesipër është marrë në funksion të sigurimit të provave të tjera dhe të zgjerimit të hetimeve lidhur me veprën penale të "Pastrimi i produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale", që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal dhe u është derguar për veprim Bankave të Nivelit të Dytë.

Nga ana e kerkuesit {...} me datë 10.05.2017, është paraqitur në Gjykatë kërkesa me objekt: Heqja e masës së sekuestrimit të vendosur me vendimin e Prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqesor Durrës datë 26.11.2015 kundër kerkueseve {...} mbi depozitat bankare.

Gjykata shqyrtoi me kujdes të gjithë materialet e çështjes dhe konkludon se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, vendimi i datës 26.11.2015 që ka vendosur sekuestrimin (bllokimin) e shumave të depozituara në llogaritë (depozitat) nga kerkuesi {...} është bërë në përputhje me nenin 210 të K.Pr.Penal në të cilin citohet se "Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumentave, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari njëdhese dhe çdo gjeje tjetër edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë kur ka arsye për të menduar se ato kanë ndihje me veprën penale, edhe kur nuk i perkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emrin e tij, në rast të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori"

Mbi bazën e dyshimeve të krijuara për origjinin, burimin e këtyre shumave të depozituara referuar dhe veprimeve bankare të kryera si terheqje apo depozitime të shpeshta të kryera në llogarinë e kerkuesit {...} është vënë sekuestro mbi keto depozita.

Ky vendim nuk është nxjerrë në bazë të ligjit nr 10192 dt. 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" por është marrë në zbatim të nenit 210 të K.Pr.Penal në funksion të një hetimi penal dhe jo hetimi administrativ - pasuror.

Për shkak të mësiperme, Gjykata vlerëson se kërkesa e bërë nga kerkuesi nuk është e mbështetur në prova dhe ligj e duhet rrëzuar.

Për këto arsye

Baza Ligjore:

Ne zbatim të nenit 210, 212 të Kodit Procedures Penale, Gjykata

VENDOSI:**Vendosi:**

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit {...} me objekt: Heqja e masës së sekuestros së vendosur me vendimin e Prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës date 26.11.2015 kundër kërkuarit {...} mbi depozitat bankare.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit
3. Kunder vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmeja e shpalljes së tij.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:**Eda Kaja**